



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 17.03.2025
Numër i protokollit: 1741/2025

A.nr. 281/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.281/2025, të datës 06.02.2025, të parashtruar nga ankuesi, S.B, në çështjen juridike “*Kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 17.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.281/2025 e datës 06.02.2025, e parashtruar nga ankuesi, S.B

A r s y e t i m

S.B, (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), i punësuar në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, më datë 06.02.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.T-09/25, të datës 09.01.2025, të Komisionit Disiplinor, në Autoritetin e Konkurrencës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke iu referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesi është e palejuar, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës konstaton se ankuesi është i punësuar në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës (me tej vetëm AKRK) dhe se i njëjti mbanë pozitën e punës Drejtor i Përgjithshëm i Sekretariatit të AKRK-së.

Ankuesi, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.T-09/25 të protokolluar me numër 16/25-13/B, të datës 09.01.2025, të Komisionit Disiplinor në AKRK, me pretendimin ankimor se në arsyetimin e këtij vendimi nuk janë shqyrtuar të gjitha pretendimet dhe provat e paraqitura. Kërkon nga Këshilli që nëpunësin civil me inicialet SH.E ta largoj nga shërbimi civil i Kosovës, duke e liruar nga pozita e tij si Inspektor Hetues i Konkurrencës në Autoritetin e Konkurrencës.

Kolegji i Këshillit bazuar në analizimin e shkresave të lëndës ka gjetur së Komisioni Disiplinor i AKRK-së, në procedurë disiplinore ndaj nëpunësit civil Shemsi Elezi, ka aprovuar pjesërisht kërkesën e ankuesit në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm, nr.prot.647-06/B të datës 27.09.2024, ashtu që ankuesin ka shpall përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore lidhur me mos respektimin e Rregullores Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vjueshmërinë e Zyrtarëve Publik, duke i shqiptuar masën disiplinore “ *ndalim prej njëzet për qind (29%) e pagës bazë, për periudhën prej gjashtë (6) mujore*, duke filluar nga data 01.02.2025.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 14 ku përcaktohet se “Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenojë të drejtat apo interesat juridike. 2. Palë në procedurën administrative janë, gjithashtu, dhe mbrojtësit e interesave publike të autorizuar me ligj të veçantë, si dhe mbrojtësit e interesave kolektive apo të interesave të gjera të publikut, nëse këto interesa mund të cenohen nga rezultati i procedurës administrative”, si dhe nenit 124 paragrafi 1 të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim, dhe si rrjedhojë referuar dispozitave përkatëse ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se më vendimin e kundërshtuar më ankesë ankuesit nuk i është cenuar ndonjë të drejtë apo interes juridik lidhur me marrëdhënien e tij të punës, andaj, mbi këtë konstatim i njëjti nuk ka legjitimitetin e palës në këtë çështje juridiko-administrative, dhe rrjedhimisht në mungesë të legjitimitetit të palës ankesa A.nr.281/2024 është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Kështu që, për sa me sipër, Kolegji duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.281/2025

Kaltrina Avdullahi

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit, S.B*
- *Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Autoritetin e Konkurrencës të Republikës së Kosovës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*